

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren - departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Gani Kastrati, me pjesmarrjen e sekretarës juridike Mire Beqiraj me procesmbajtëse, në çështjen penale të akuzuarit: O.(I).B nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320, të KP-së, sipas aktakuzues të Prokurorisë Themelore në Prizren PP/II.nr.1271/14, të datës 27.06.2014, para mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor , me datë 10.07.2017, morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të akuzuarit:

O.B, nga i ati I., nga Prizreni rruga „ ...”, pn., ku dhe tani jeton, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Konform nenit 363 par.1 nën parag. 1.1 të KPP-së.

REFUZOHET AKUZA

Prej datës së pavërtetuar e deri me datën 05.12.2013, në Prizren, në rrugën „”, pn., pikërisht në shtëpin e tij, mere perdor devijon, nxjerr ose përfiton nga ndonjë shërbim komunal që furnizohet nga ose perms mjetit përques të rrymes apo rrjetit të shperndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, në atë mënyrë I pandehuri shfrytëzon energjin elektrike me njehësor I cili , bllobat shtetërore I ka të manipuluar, të hapura, prap të mbyllura, numruesi I njehësorit, është I manipuluar ka gjurm të gervishjes së numrave në numer rator, ashtu që energjia e shpenzuar nuk është regjistruar , në këtë mënyrë ndermarrjes së demtuar ...-s, Depertamenti ligjor në Prizren, I ka shkaktuar dem materjal në shumen prej 325.87 €.

Kësodore kishte për të kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320, të KP-së.

Për shkak se përfaqsesi i PSH në Prizren – prokurori para mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në mbështetje të nenit 363 par.1 nenparag. 1. 1 të KPP, është tërhequr nga aktakuza.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren- Depermtamenti i përgjithëshem, kësaj Gjykate, i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.1271/14, të datës 27.06.2014, kundër të akuzuarit : O.(I).B nga Prizreni, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale, nga neni 320, të KP-së.

Para hapjes – caktimit dhe zhvillimit të seancës së shqyrtimit fillestar, Gjykata ka pranuar aktin P.nr. 1017/14, me datën 22.03.2017, të ushtruar nga Prokuroria Themelore në Prizren, për tërheqjen nga aktakuza PP/II.nr. 1271/14, të dt. 27.06.2014, kundër të pandehurit : O.B , përshkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320, të KP-së, me arsyetimin se pasi që zyra ligjore e kompanis Kosovare, për distribuim dhe furnizim me energji elektrike „...”, me shkresën e saj të datës 17.03.2017, me nr .390 , të dt. 20.03.2017, ka njoftuar Prokurorin Themelore në Prizren, se tek i pandehuri : O.(I).B kanë bërë ngatërres , dhe se ... ,, .., me ID...., nuk i përket O.(I).B dhe se tërhiqen nga kallëzimi penal i iniciuar nga, me nr. CMS-K/1031, e cila kërkes është bashkangjitur aktit zyrtarë të Prokuroris Themelore në Prizren, për tërheqjen e aktakuzës para se të fillohet me zhvillimin e procedurës penale. Prandaj kjo është arsyea që Prokuroria Themelore në Prizren, në bazë të të dhënave të cekura më lartë , tërhiqen nga aktakuza PP/II.nr. 1271/14, të dt. 27.06.2014, kundër të pandehurit O.(I).B, përshkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320, të KP-së.

Megjenëse Prokurori i Shtetit në Prizren, para hapjes së shqyrtimit fillestar gjyqësor , është tërhequr nga aktakuza kundër të akuzuarit: O.B, gjykata konform nenit 363 par.1 nën parag. 1 .1 të KPP-së ka vendosur si në shqiptim të këtij aktgjykimi, pasi që në kuptim të dispozitave ligjore , ndjekja penale ndalohet në qdo raste kur Prokurori heq dorë nga aktakuza.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, është marrë konform nenit 463 par.1 e 3, të KPP-së.

Konform nenit 454 par.1 të KPP është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të bien në barë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN

P.nr.1017/14, të datës 10.07.2017

**Sekretare Juridike
Mire Beqiraj**

**Gjyqtari
Gani Kastrati**

UDHËZIME JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.